

Asylum Advice

Pas vendimit
- Pozitiv



Section 4A:

Pas vendimit - Pozitiv

Kjo pjesë shpjegon se çfarë ndodh nëse ju jepet ‘Leje qëndrimi’ në Mbretërinë e Bashkuar (MB) pas shqyrtimit të kërkesës tuaj për azil. Informacioni i mëposhtëm shpjegon se çfarë ndodh më tej.

4A.1 Çfarë do të thotë lloji i statusit tim?

Ka tre lloje statusi që Home Office mund t’ju japë:

1. Statusi i refugjatit

Nëse jeni pranuar si refugjat do të thotë se Home Office ka vendosur se ju përmbushni përcaktimin e refugjatit sipas Konventës së Refugjatëve dhe pranohet se ju keni një frikë të mirë-bazuar se do të persekutoheni për shkak të një ose më shumë prej kriterëve në vijim: racës tuaj, përkatësisë tuaj fetare, kombësisë tuaj, anëtarësimi tuaj në një grup të veçantë social ose opinionit tuaj politik.

Home Office fillimisht do t’ju japë leje qëndrimi (kjo është e drejta për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar) për një periudhë pesë vjeçare. Dokumentet tuaja biometrike dhe të Home Office do të konfirmojnë se jeni pranuar si refugjat.

Politika aktuale e imigracionit përcakton se pas një periudhe 5 vjeçare nën statusin e refugjatit dhe mbrojtjes humanitare mund të aplikoni për ‘Leje të përhershme qëndrimi’ (leje pa kushte afati kohor, që shpesh quhet dhe ‘rregullimi’)

Megjithatë, nëse ju ose ndonjë prej personave që varen nga ju jeni dënuar për shkelje penale leja mund të refuzohet.

2. Mbrojtja humanitare

Kjo do të thotë se Home Office ka vendosur se ju nuk i plotësoni kriteret për status refugjati, por e pranon se ka arsye që tregojnë se nëse ktheheni në vendin tuaj të origjinës, mund të përballeni me rrezikun e vërtetë nga lëndimi i rëndë. Kjo mund të jetë për shkak të:

- dënimit me vdekje/ekzekutimit,
- vrasjes së paligjshme
- torturës
- trajtimit çnjerëzor dhe degradues

- ndëshkimit ose një kërcënimi serioz dhe individual ndaj jetës tuaj për shkak të dhunës pa kriter në situata të konflikteve të armatosura ndërkombëtare ose të brendshme.

Nëse ju jepet Mbrojtje Humanitare do t'ju jepet 'leje qëndrimi' (e drejta për të qëndruar) në Mbretërinë e Bashkuar për pesë vjet. Dokumentacioni juaj do të konfirmojë se ju është dhënë leja e qëndrimit për arsye humanitare.

Politika aktuale e imigracionit përcakton se pas periudhës 5 vjeçare të mbrojtjes humanitare mund të aplikoni për 'Leje qëndrimi të përhershme'.

3. Leja e veçantë e qëndrimit

Nëse Home Office nuk e pranon se ju i plotësoni kërkesat për mbrojtje humanitare ose status refugjati, por e pranon se ka arsye të jashtëzakonshme që të lejoheni të qëndroni përkohësisht, do t'ju jepet 'leje e veçantë qëndrimi' (e drejta për të qëndruar).

Leja e veçantë e qëndrimit zakonisht jepet për një maksimum prej dy vjet e gjysmë (30 muaj) çdo herë. Ju keni të drejtën që të aplikoni për ta shtyrë lejen tuaj dhe pas dhjetë vjetësh mund të aplikoni për 'Leje qëndrimi të përhershme'.

4A.2 Nëse nuk më jepet statusi i refugjatit a mund të apeloj?

Nëse ju jepet mbrojtje humanitare ose leje e veçantë qëndrimi, që është për më gjatë se 12 muaj, por ju besoni se keni arsye të forta për status refugjati atëherë mund të apelonit ndaj vendimit të Home Office. Ky quhet një apel për përmirësim; ju duhet ta diskutoni këtë me këshilltarin tuaj ligjor. Nëse dilni me sukses do t'ju jepet statusi i refugjatit.

4A.3 Çfarë ndodh kur leja ime i afrohet fundit?

Aplikimin tuaj mund ta paraqisni 28 ditë përpara se të përfundojë leja juaj.

Është e rëndësishme që aplikimi juaj të merret përpara datës kur përfundon leja. Nëse Home Office nuk e ka marrë vendimin mbi aplikimin tuaj përpara se të ketë përfunduar leja juaj aktuale e qëndrimit ju mund të vazhdoni të keni të njëjtat të drejta si më parë. Nëse aplikimi juaj merret nga Home Office pasi të ketë përfunduar leja juaj, atëherë mundet që të bëheni i paligjshëm në Mbretërinë e Bashkuar. Kjo mund të nënkuptojë që ju i humbisni të drejtat për të punuar, për të marrë ndihma financiare dhe gjithçka që keni të drejtë për shkak të lejes. Nëse kjo gjë ndodh, duhet të merrni menjëherë këshilla ligjore. Informacioni rreth kësaj mund të gjendet në faqen e internetit mbi imigracionin të Home Office.

Nëse ju është dhënë 'Leje e veçantë qëndrimi' duhet të aplikoni për periudha të

mëtejshme të 'Lejes së mëtejshme të qëndrimit'. Leja e mëtejshme do t'ju jepet për sa kohë që ju vazhdoni të kualifikoheni për të sipas politikës. Këtë duhet ta bëni deri sa të keni leje qëndrimi për një periudhë totale prej dhjetë vjetësh. Informacioni mund të gjendet në faqen e internetit të Home Office në lidhje me aplikimin për leje të mëtejshme qëndrimi: <https://www.gov.uk/browse/visas-immigration>. Pas kësaj pike do të mund të aplikoni për 'leje të përhershme qëndrimi'. Nëse aplikimi juaj është i suksesshëm, nuk ka kufizime kohore të mëtejshme mbi të drejtën tuaj për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar.

Shënim i rëndësishëm: Është e rëndësishme që të dini gjithë ndryshimet në politikat e imigracionit të cilat mund të ndryshojnë gjatë kohës. Këtë mund ta bëni duke lexuar faqen e internetit të Home Office: <https://www.gov.uk/browse/visas-immigration>.

4A.4 Çfarë dokumentesh do të më jepen?

Karta biometrike

Do të merrni një leje qëndrimi biometrike (kartë biometrike). Ky dokument është i ngjashëm me kartën tuaj ARC. Karta juaj biometrike është provë se keni të drejtën të qëndroni, të punoni dhe të studioni në Mbretërinë e Bashkuar. Kartën tuaj biometrike duhet ta përdorni si një formë identifikimi. Duhet ta tregoni kur aplikoni për një llogari bankare në Mbretërinë e Bashkuar. Nuk ju nevojitet që ta mbani këtë kartë me vete gjithë kohën, por do t'ju duhet ta tregoni kur të konfirmoni të drejtat tuaja në Mbretërinë e Bashkuar.

Karta juaj biometrike do t'ju postohet me postë të sigurt ju ose këshilltarit tuaj ligjor. Ju do të merrni një kartë për secilin pjesëtar të familjes.

Karta juaj biometrike tregon emrin, gjininë, datën dhe vendin tuaj të lindjes, fotografinë tuaj, statusin tuaj të imigracionit, kur ju përfundon leja, të dhënat e të drejtave tuaja dhe nënshkrimin tuaj. Çipi biometrik në kartë përmban shenjat tuaja të gishtërinjve dhe fotografinë tuaj.

Shënim i rëndësishëm: ju duhet të kontrolloni që të gjitha të dhënat të jenë të sakta në kartën tuaj. Duhet që ta raportoni çdo gabim menjëherë te Home Office. Ju duhet të raportoni çdo gabim brenda 10 ditëve të punës nga marrja e kartës tuaj. Në qoftë se ju nuk e bëni ju mund t'ju duhet të ri-aplikoni dhe të paguani për zëvendësimin e kartës biometrike. Ju mund të dërgoni email tek: BRPErrors@homeoffice.gsi.gov.uk

Përfshini informacionin e vijuar në email tuaj:

- numrin e pasaportës tuaj
- numrin e lejes biometrike tuaj të qëndrimit

- numrin e referencës së çështjes tuaj
- një numër telefoni kontakti
- detajet saktësisht se çfarë informacioni është i gabuar

Çfarë ndodh nëse humbas kartën time biometrike?

Nëse ju ka humbur ose jua kanë vjedhur kartën tuaj biometrike, duhet të njoftoni Home Office sa më parë që të jetë e mundur. Home Office do të duhet ta anulojë kartën tuaj biometrike. Ligji kërkon që ju ta anuloni kartën dhe ju duhet të njoftoni Home Office me email në: BRPLost@homeoffice.gsi.gov.uk.

Në emailin tuaj duhet të shkruani:

- emrin dhe mbiemrin tuaj të plotë
- datën tuaj të lindjes;
- kombësisë tuaj;
- numrin tuaj të pasaportës;
- numrin e referencës së kartës tuaj biometrike;
- numrin e referencës së çështjes tuaj;
- të dhënat tuaja të kontaktit; dhe
- kur, ku dhe si ju humbi ose jua vodhën lejen tuaj.

Duhet të raportoni se e keni humbur ose se jua kanë vjedhur kartën edhe në polici e të merrni një raport të policisë dhe numrin e referencës së krimit, sa më parë që të jetë e mundur. Nëse karta juaj është vjedhur ju duhet të raportoni krimin në stacionin tuaj të policisë. Nëse karta juaj ka humbur, atëherë ju do të duhet të raportoni atë nëpërmjet <https://www.reportmyloss.com> - Kushton £3.95 në shumicën e zonave për të raportuar një humbje të tillë. Ju do t'ju duhet një kartë debiti/krediti për ta bërë këtë.

Do të nevojitet të aplikoni për një kartë zëvendësuese biometrike. Ky informacion mund të gjendet tek faja e Home Office: <https://www.gov.uk/biometric-residence-permits>.

Numri i Sigurimeve Shoqërore (NINO)

Si pjesë e intervistës tuaj të zgjeruar duhet të jeni intervistuar për një Numër të Sigurimeve Shoqërore. Numri juaj i Sigurimeve Shoqërore është një numër reference që është unik për ju. Ai përdoret në Mbretërinë e Bashkuar për të administruar sistemin e sigurimeve shoqërore dhe sigurisë sociale. Yju do të keni të njëjtin numër gjatë gjithë jetës tuaj. Ai siguron që kontributet e sigurimeve shoqërore kombëtare dhe taksat që paguani të regjistrohen siç duhet nën emrin tuaj. Ai vepron edhe si numër reference kur komunikohet me Department for Work and Pensions (DWP) dhe HM Revenue &

Customs (HMRC).

Numrat e Sigurimeve Shoqërore Kombëtare zakonisht ju lëshohen personave mbi moshën 16 vjeç.

Vartësit e rritur nuk intervistohen për numër të sigurimeve shoqërore gjatë intervistës për azil. Për këtë arsye ata nuk marrin automatikisht një numër të sigurimeve shoqërore. Ju duhet të kontaktoni Department of Work and Pensions dhe ata do të organizojnë numrin e sigurimeve shoqërore për personat që varen nga ju.

Nëse ju duhet të aplikoni për një numër të sigurimeve shoqërore pasi do të filloni punë ose doni të jeni i vetë-punësuar atëherë duhet të kontaktoni:

Job Centre Plus
0845 600 0643

Nëse po aplikoni për ndihma atëherë Department for Work and Pensions (DWP Job centre) do të plotësojë një formular të sigurimeve shoqërore kombëtare me ju gjatë intervistës në qendrën e punës. Ky formular quhet një 'formulari DCI 1B'. Kjo gjë do të kërkojë që t'ju jepet një Numër i Sigurimeve Shoqërore Kombëtare (NINO).

Nëse thirrni për intervistë mbi Numrin e Sigurimeve Shoqërore Kombëtare, duhet të provoni identitetin tuaj dhe përshtatshmërinë për të punuar në Mbretërinë e Bashkuar. Karta juaj biometrike mund ta provojë këtë gjë. Y Mund t'ju kërkohet edhe që të merrni dokumente të tjera identiteti me vete. Do t'ju jepet një letër në të cilën do të konfirmohet se çfarë informacioni duhet të merrni me vete.

4A.5 Të dhënat në lidhje me Huanë e Integritimit

Nëse keni marrë mbrojtje humanitare ose status refugjati mund të aplikoni për një 'Hua Integritimi'. Huaja e integritimit është një skemë huash e ngritur nga Home Office për të ndihmuar në fazat e para të integritimit. Huatë mund të shpenzohen për sende dhe aktivitete që lehtësojnë integritimin të tilla si:

- Trajnimi profesional kur nuk është i mundur nëpërmjet Job Centre Plus. Kjo gjë duhet diskutuar me këshilltarin tuaj në Job Centre.
- Një depozitë për akomodim;
- Blerjen e sendeve jetike për shtëpinë; Ose
- Blerjen e mjeteve të profesionit.

Nëse nuk keni llogari bankare do të mund të aplikoni për një maksimum prej £450. Prandaj, është e rëndësishme që të hapni llogari bankare nëse po aplikoni për më

shumë para. Ripagesat e huasë i duhen bërë me këste të rregullta Department for Work and Pensions (DWP). Ato do të bëhen ose direkt nga llogaria juaj bankare. Në shumicën e rasteve ripagesa e huasë do të fillojë gjashtë javë pasi fondet t'i jenë dhënë individit. Duhet të nënshkruani një formular të marrëveshjes së huasë përpara se t'ju jepet huaja. Nuk do të mund të aplikoni për një hua integrimi pa Numër të Sigurimeve Shoqërore. Aplikimi do të konsiderohet si i paplotë dhe do të refuzohet nëse aplikoni pa të dhe do t'ju kthehet. Më shumë informata mund të gjenden në: <https://www.gov.uk/refugee-integration-loan/overview>.

4A.6 NASS 35

Nëse keni marrë mbështetje nga Home Office do të merrni një NASS 35. Ky është një dokument i laminuar A4 i cili përfshin fotografinë tuaj dhe të dhënat e mbështetjes tuaj. Dokumenti do t'ju dërgohet nga Support Team i Home Office. Ai do të konfirmojë mbështetjen që keni marrë dhe do të konfirmojë se kur do të ndërpritet mbështetja juaj. E gjithë mbështetja nga Home Office do të përfundojë 28 ditë nga data që ju ose këshilltari juaj ligjor keni marrë njoftimin e vendimit tuaj. Nëse keni nevojë për ndihmë me aplikimin për NASS 35 atëherë ju lutem kontaktoni Asylum Help në 0808 8000 620.

4A.7 Si do ta mbështes veten dhe familjen time financiarisht?

Home Office nuk është më përgjegjës që t'ju mbështesë 28 ditë pasi të keni marrë njoftimin e statusit tuaj. Ju do të merrni një letër si nga Home Office dhe nga ofruesi i akomodimit tuaj (nëse mbështeteni nga Home Office), në të cilën do të konfirmohet se në cilën datë do të ndërpritet mbështetja juaj dhe në cilën datë ju duhet të largoheni nga akomodimi juaj. Duhet që të largoheni nga akomodimi juaj dhe t'i hiqni të gjitha sendet tuaja deri në këtë datë.

4A.8 Akomodimi: Angli dhe Uells

Nevoja prioritare për akomodim (strehimi emergjent ose i përkohshëm)

Ju mund t'i kërkonte departamentit për strehimin të bashkisë që t'ju ndihmojë nëse jeni të pastrehë. Bashkia ku keni jetuar është e detyruar ligjërisht që t'ju japë këshilla dhe ndihmë. Në vartësi të situatës tuaj personale, atyre mund t'ju duhet që t'ju ofrojnë akomodim.

Nëse mendoni se mund të keni një nevojë prioritare (kjo mund të jetë për shkak të;

fëmijëve në familjen tuaj, dikujt që vuan nga një sëmundje e rëndë – mendore apo fizike, të qenit në rrezik nga dhuna në familje), zyrës së strehimit mund t'u duhet t'ju ofrojnë akomodim. Ju duhet të paraqisni një aplikim si person i pastrehë. Bashkia vendore do ta vlerësojë këtë për të parë nëse e kanë për detyrë që t'ju ofrojë

akomodim. Ata do të vlerësojnë nëse jeni të pastrehë, keni nevoja prioritare, e keni bërë veten të pastrehë me dëshirë dhe/ose keni një lidhje vendore.

Nëse bashkia ju vlerëson si ‘nevojë prioritare’ atëherë ata do t’ju ofrojnë strehim emergjent ose të përkohshëm. Akomodimi emergjent ka të ngjarë që të jetë akomodim fjetje me mëngjes ose një bujtinë. Ligji thotë se bashkia nuk duhet t’i mbajë familjet dhe gratë shtatzëna në akomodim me fjetje dhe ngrënie për më shumë se 6 javë.

Ju duhet të kërkonti këshilla nga:

Shelter – ata mund t’ju japin këshilla të pavarura në lidhje me të drejtat e strehimit dhe mund të kontaktohen në numrin: 0800 800 4444

Ju po ashtu mund të gjeni një qendër të pavarur këshillimi për strehimin në zonën ku jetoni.

Nëse bashkia e pranon se jeni të pastrehë dhe bie dakord se e ka për detyrë që t’ju strehojë. Ata mund t’ju ofrojnë:

- 1) Banesë të bashkisë
- 2) Banesë nga Shoqata Strehimi
- 3) T’ju sigurojë akomodim të marrë me qira afatgjatë.

Pasi t’ju jetë bërë një ofertë e përshtatshme, detyra e tyre përfundon.

Nëse mendoni se akomodimi nuk është i përshtatshëm, është e rëndësishme që të kërkonti këshilla të pavarura përpara se ta refuzoni ofertën. Nëse e refuzoni ofertën e akomodimit dhe ajo konsiderohet si e përshtatshme për nevojat tuaja atëherë, bashkia ka të drejtën ta përfundojë detyrën e tyre ndaj jush. Ata mund ta ndërpresin strehimin e emergjencës pasi ju do të konsideroheni se ‘e keni bërë veten të pastrehë me qëllim’.

Shelter – ata mund t’ju japin këshilla të pavarura në lidhje me të drejtat e strehimit dhe mund të kontaktohen në numrin: 0800 800 4444

Ju po ashtu mund të gjeni një qendër të pavarur këshillimi për strehimin në zonën ku jetoni.

Akomodimi privat

Nëse nuk konsideroheni të jeni një nevojë prioritare atëherë do t’ju duhet të kërkonti akomodim privat me qira. Mund të apeloni nëse mendoni se jeni një çështje prioritare dhe nuk jeni pranuar nga bashkia. Në këto rrethana duhet të kërkonti këshilla ligjore të pavarura.

Nëse do të siguron akomodim, shumica e pronarëve do të kërkojë një depozitë dhe qiranë e një muaji. Një agjenci strehimi vendore do të mund të konfirmojë nëse mund t'ju ofrohet ndihmë ose asistencë për këtë gjë në zonën tuaj. Për shembull mund të ketë skema të obligacioneve vendore ose depozitave për qiranë. Po ashtu mund të aplikoni për një hua integrimi që të ndihmoheni me këtë.

I pastrehë që jeton në rrugë

Nëse jeni i pastrehë që jeton në rrugë, atëherë ka organizata në zonën ku banoni që mund t'ju ndihmojnë. Këshilli i juaj bashkiak duhet të jetë në gjendje t'ju ndihmojnë për të marrë detajet e organizatave lokale dhe/ose qendra strehimi të natës që ndoshta janë në gjendje t'ju ndihmojnë. Kjo ndihmë mundet të jetë një vend i sigurt për të fjetur, jorganë gjumi apo vakte të ngrohta.

Po ashtu mund të kontaktoni SHELTER; ata mund t'ju japin këshilla të pavarura në lidhje me gjithë të drejtat për strehimin dhe mund të kontaktohen në numrin 0800 800 4444.

Mund të përdorni:

Shërbimet ditore - ata mund t'ju ndihmojnë me ushqime, veshje dhe larjen. Ata duhet të jenë në gjendje t'ju ofrojnë edhe këshilla të pavarura.

Bujtinat e emergjencës dhe vendstrehimet gjatë natës - mund të gjeni strehim për pak net nëse jetoni rrugëve.

Mund të kontaktoni edhe STREETLINK në numrin 0300 500 0914 të cilët do të mund t'ju ofrojnë këshilla.

4A.9 Akomodimi: Skoci

Mund t'i kërkonit Departamentit të Strehimit të Bashkisë vendore ndihmë nëse nuk keni vend për të jetuar. Bashkia ku jetoni është e detyruar ligjërisht që t'ju japë këshilla dhe ndihmë. Nëse keni bërë një aplikim si i pastrehë do t'ju jepet mbështetje emergjente ndërkohë që departamenti i strehimit vlerëson përshtatshmërinë tuaj. Nëse bashkia nuk ka akomodim të përshtatshëm në zonën ku jetoni duhet që t'ju ofrojë akomodim jashtë zonës ku jetoni.

Nëse vendosin se e kanë për detyrë që t'ju mbështesin, atëherë ata do t'ju ofrojnë akomodim të përhershëm. Ju mund të qëndroni në akomodimin tuaj të përkohshëm derisa t'ju jetë ofruar akomodim i përhershëm.

Nëse nuk e kanë për detyrë që t'ju ofrojnë mbështetje afatgjatë atëherë duhet të qëndroni në akomodimin e emergjencës, ndërkohë që gjeni një vend të përhershëm

për të jetuar. Nëse bashkia nuk ju ofron akomodim emergjence atëherë duhet të kontaktoni një agjenci këshilluese për strehimin që t'ju ndihmojë.

Opsionet e strehimit të emergjencës nëse jeni të pastrehë janë:

- bujtina, vendstrehime gjatë natës dhe vendstrehime për dimrin
- dhunë në familje dhe gratë refugjate
- hotele me fjetje dhe mëngjes.

Bashkia vendore duhet që t'ju japë më shumë informacion. Po ashtu mund të kërkonti ndihmë edhe nga një agjenci vendore strehimi. Ju mund të aplikoni për ndihma financiare për strehimin që t'ju ndihmojë me koston. Disa opsione akomodimi mund të jenë të shtrenjta prandaj mund t'ju duhet ta paguani vetë pjesën e qirasë që nuk mbulohet nga ndihma juaj për strehim.

Shënim i rëndësishëm: Departamenti Vendor i Strehimit ose Qendra e Këshillimit për Strehimin duhet të konfirmojë nëse ka vendstrehime për gjatë natës dhe bujtina në zonën ku jetoni.

Për informacion të mëtejshëm në lidhje me strehimin ju lutemi kontaktoni Shelter në numrin 0800 800 4444. Ata mund t'ju japin këshilla të pavarura dhe t'ju drejtojnë te shërbimet e duhura.

4A.10 Akomodimi: Irlanda e Veriut

Northern Ireland Housing Executive (NIHE) e ka detyrë ligjore t'ju ofrojë ndihmë dhe këshilla nëse bëheni të pastrehë.

Në vartësi të situatës tuaj personale, ata mund t'ju ofrojnë akomodim.

Ju duhet të paraqisni një aplikim si person i pastrehë. NIHE do ta shqyrtojë këtë për të parë nëse e kanë për detyrë që t'ju ofrojnë akomodim. Ata do të vlerësojnë nëse jeni të pastrehë, keni nevoja prioritare, e keni bërë veten të pastrehë me dëshirë dhe/ose keni një lidhje vendore. Ata mund t'ju ofrojnë akomodim të përkohshëm ndërkohë që hetojnë rrethanat tuaja.

Nëse vlerësoheni si nevojë prioritare (kjo mund të jetë për shkak të: fëmijëve në familjen tuaj, një person që vuan nga një sëmundje e rëndë – mendore ose fizike, që është në rrezik nga dhuna në familje, dhe plotëson kritere të tjera, NIHE duhet t'ju ndihmojë të gjeni akomodim të përshtatshëm që të jetoni. Akomodimi duhet që t'ju ofrohet për të paktën dy vjet. Ata nuk janë të detyruar t'ju ofrojnë strehim të përhershëm.

Për më shumë informacion telefononi NIHE në numrin 03448 920 920.

4A.11 Ndhima financiare për strehimin, Ndhima financiare vendore për strehim dhe ndihma me taksat e bashkisë.

Nëse keni të ardhura të ulëta dhe merrni ndihma sociale, mund të merrni ndihma financiare për strehimin ose ndihmë financiare vendore për strehimin që të ndihmoheni të paguani një pjesë ose gjithë qiranë e banesës tuaj. Për këtë duhet të aplikoni te bashkia. Mund të aplikoni edhe për ndihmë me taksat tuaja të bashkisë. Shpesh ndihma me strehimin/mbështetja për strehimin është në të njëjtin formular.

4A.12 Ndhimat e mirëqenies sociale

Krediti Universal

Qeveria është gradualisht duke propozuar një pagesë të re të vetme të quajtur Universal Credit për njerëzit që janë në kërkim të punësimit ose janë në punësim me të ardhura të ulëta. Ajo pagesë sjell së bashku një sërë ndihmash, duke përfshirë Jobseeker's Allowance dhe Housing Benefit në një pagesë të vetme.

Krediti Universal është duke u propozuar me faza. Për të parë nëse jetoni në një zonë ku ju mund të kërkoni Universal Credit shih: <https://www.gov.uk/universal-credit> Ju mund të kërkoni Universal Credit ne internet në <https://www.gov.uk/universal-credit>. Nëse keni pyetje ju mund të kontaktoni linjën ndihmëse të Universal Credit: 0345 600 0723 (thirrjet janë me pagesë).

Në qoftë se ju nuk mund të mbuloheni prej Credit Universale atherë, nëse keni të drejtë, ju mund të kërkoni ndihmat e përmendura më poshtë.

Ndhima për të papunët (JSA)

Kjo është një ndihmë për personat që aktualisht po kërkojnë punë ose punojnë mesatarisht më pak se 16 orë në javë.

Duhet të plotësoni një marrëveshje të punëkërkesit ose formularin e ri të angazhimit të kërkesit. Këto dokumente përcaktojnë se çfarë duhet të bëni që të gjeni punë. Ato përcaktojnë përgjegjësinë tuaj se do të bëni çfarë të mundeni për të gjetur punë në përgjigje të mbështetjes.

Ndërkohë që merrni Ndhimën për të Papunët (JSA) ju duhet të regjistroni gjithë veprimet që keni bërë për të gjetur punë. Nëse nuk i përmbushni angazhimet tuaja zyra e punës mund t'jua pezullojë ose ndalojë ndihmat tuaja.

Ju mund të kryeni kurse trajnimi të ofruara nga zyra e punës. Ato mund të përfshijnë mësimet të anglishtes (ESOL). Këtë duhet ta diskutoni me zyrën e punës.

Ndihma mbi të ardhurat

Ndihma mbi të ardhurat është një ndihmë sociale që i paguhet disa grupe njerëzish të cilët nuk kanë para të mjaftueshme për të jetuar. Ajo bazohet mbi testimin e mjeteve të jetesës, gjë e cila do të thotë se merren parasysh gjithë paratë që keni për të vendosur se sa mbështetje mbi të ardhurat duhet të merrni.

Angli, Skoci dhe Uells

Që të kualifikoheni për Ndhmën mbi të Ardhurat duhet të jeni:

- nga mosha 16 vjeç deri në moshën e kreditit të pensionit
- shtatzënë ose kujdestarë; një prind i vetëm me një fëmijë nën moshën 5 vjeç ose, në disa raste, të mos jeni në gjendje të punoni për shkak se jeni sëmurë ose të paaftë për punë
- pa një të ardhur ose me të ardhura të ulëta
- të punoni më pak se 16 orë në javë (dhe partneri juaj punon jo më shumë se 24 orë në javë).

Irlanda e Veriut

Që të kualifikoheni për Ndhmën mbi të Ardhurat në Irlandën e Veriut duhet të jeni:

- nga mosha 16 vjeç deri në moshën e kreditit të pensionit
- me të ardhura të ulëta
- të punoni më pak se 16 orë në javë, në vartësi të shumës së pagës tuaj
- të mos jeni duke studiuar me kohë të plotë (por ka disa përjashtime)
- të mos jeni duke marrë Ndhmë për të Papunët ose Ndhmë për Punësimin dhe Mbështetjen
- të mos keni kursime mbi £16.000
- të jetoni në Irlandën e Veriut

Ose

- të jeni prind i vetëm
- me leje për prindërit ose për shkak se ju ka lindur një fëmijë
- një kujdestar apo kujdestare
- Një refugjat që mëson anglisht që ka ardhur jo më herët se një vit më parë

Ndihma për Mbështetjen e Punësimit (ESA)

Kjo pagesë është për personat që kanë një sëmundje ose një paaftësi që do të thotë se nuk mund të punojnë, ose janë të kufizuar në llojin e punës që mund të bëjnë. Ndërkohë që merrni këtë ndihmë, qendra e punës do t'ju japë një këshillues personal të trajnuar veçanërisht. Ata mund t'ju ofrojnë një numër të gjerë shërbimesh të tjera që janë krijuar për t'ju ndihmuar të gjeni punësim të përshtatshëm.

Job Centre mund t'ju kërkojë të plotësoni një pyetësor ose të ndiqni një 'vlerësim të aftësisë për të punuar'. Ata mund të vlerësojnë edhe nëse mund të bëni hapa për të gjetur punë, ose nëse sëmundja ose paaftësia juaj ndikon kaq shumë mbi aftësinë tuaj për të punuar sa këto hapa nuk do të ishin të arsyeshme.

Mund t'ju kërkohet që të kontrolloheni nga një mjek ose infermiere të cilët do të plotësojnë një vlerësim dhe do t'ia dërgojnë DWP. Vlerësimi do të konfirmojë kufizimet e sëmundjes ose paaftësisë tuaj, sasinë dhe llojin e punës që mund të bëni dhe nëse kualifikoheni për Ndhimën e Mbështetjes dhe Punësimit.

Ka dy lloje ndihmash të këtij lloji:

Grupi i aktiviteteve që ka lidhje me punën - Grupi i aktiviteteve që ka lidhje me punën

– Kjo ndodh nëse DWP mendon se jeni në gjendje të punoni në të ardhmen.

Job Centre do të presë që të merrni pjesë në çdo intervistë të përqendruar te puna në të cilat ju ftojnë dhe mund t'ju duhet të merrni pjesë edhe në një aktivitet që ka lidhje me punën ose ata mund të reduktojnë ndihmat tuaja.

Grupi i mbështetjes - Kjo do të thotë se DWP ka vendosur se gjendja juaj kufizon punën që mund të bëni. Ju mund të merrni pjesë në intervista që përqendrohen te puna dhe aktivitete që kanë lidhje me punën nëse dëshironi.

Ndihma për fëmijët

Mund të jeni në gjendje që të merrni Ndhimë për fëmijët nëse fëmija juaj është:

- nën moshën 16 vjeç
- mbi moshën 16 vjeç por nën moshën 20 vjeç – dhe ndjek shkollën ose trajnim që pranohet nga Ndhimë për Fëmijët
- nën moshën 18 vjeç dhe e ka mbaruar shkollimin ose trajnimin kohët e fundit - por duhet të jetë regjistruar për punë, shkollim ose trajnim me shërbimin e karrierave, Connexions, shërbimet e mbështetjes së autoriteteve vendore, Ministrinë e Mbrojtjes ose organizata të ngjashme.

Nëse ju nevojiten këshilla të mëtejshme në lidhje me Ndhimën për Fëmijët telefononi: 0300 200 3103.

Krediti i taksave për fëmijët

Krediti i taksave për fëmijët mund t'i paguhet njerëzve me fëmijë që kanë të ardhura të ulëta ose marrin një ndihmë për mirëqenie.

- nën 16 vjeç - mund ta merrni deri më 31 gusht pas datëlindjes së tyre të 16-të
- nën moshën 20 vjeç – mund ta merrni nëse janë në arsim ose trajnim të miratuar

Përgjegjësia për një fëmijë

Ju zakonisht jeni përgjegjës për një fëmijë nëse ata:

- jetojnë me ju gjithë kohën;
- normalisht jetojnë me ju dhe ju jeni kujdestarët kryesorë;
- jetojnë në Evropë por janë të varur financiarisht nga ju.

Nëse fëmija është i paaftë fizik ose mendor

Mund të merrni Kredite të Taksave shtesë për fëmijët nëse fëmija:

- merr ndihma shtesë për shkak të një paaftësie.
- është i regjistruar i verbër (ose ka qenë brenda 28 javësh nga kërkesa e juaj për kredite të taksave)

Mund të kontaktoni Job Centre në:

Telefoni: 0800 055 6688 / Tekstfoni: 0800 023 4888

Këto telefonata janë pa pagesë nga një linjë tokësore por mund t'ju duhet të paguani nga celularët. Job Centre ka linja telefonike pa pagesë të cilat mund t'i përdorni.

Po ashtu disa prej aplikimeve mund t'i bëni në internet.

Për informacion mbi Ndhimat e Taksave për Fëmijët, telefononi: 0345 300 3900

Ose për ata që janë shurdhë ose kanë probleme me dëgjimin ose të folurën: 0345 300 3909

Krediti i Pensionit

Që të kualifikoheni për kredit pensioni:

- duhet të jetoni në Mbretërinë e Bashkuar;
- ju ose partneri juaj duhet të keni arritur moshën kualifikuese për kredit pensioni.

Mosha kualifikuese për Kreditin e Pensionit po ngrihet gradualisht në pajtim me rritjen e moshës së pensionit shtetëror për gratë në 65 vjeç dhe rritjen e mëtejshme në 66 vjeç për burrat dhe gratë.

Linja telefonike e kërkesave për Kreditin e Pensionit:

Telefoni: 0800 99 1234

Tekstfoni: 0800 169 0133

E hënë deri të premte, 8 e mëngjesit deri 6 e mbasdites.

4A.13 Ndhimat e tjera sociale

Mund të jeni në gjendje të aplikoni për ndihma të tjera sociale nëse jeni të sëmurë, keni një të paaftë mendor apo fizik në shtëpi, kujdeseni për dikë ose dikush kujdeset për ju ose keni mbushur moshën e thyer.

Ju mund të kontaktoni Job Centre që t’ju këshillojë për këtë ose mund të kërkonti këshilla të pavarura nga specialisti juaj i ndihmave vendore. Zyra juaj vendore e Citizens Advice Bureau mund t’ju ndihmojë: <http://www.adviceguide.org.uk>.

4A.14 Kreditet e Taksës së Punës

Nëse punoni dhe keni të ardhura të ulëta, mundet që po ashtu të aplikoni për kredite të taksës së punës.

Ju duhet të punoni një numër të caktuar orësh në javë për t’u kualifikuar:

Nëse jeni nga mosha 25 deri 59 vjeç - orët e punës në javë: Të paktën 30 orë në javë.

Nëse jeni 60 vjeç ose më të moshuar – Orët e punës në javë: Të paktën 16 orë në javë.

Nëse jeni person me paaftësi – Orët e punës në javë: Të paktën 16 orë në javë.

Nëse jeni prind i vetëm me 1 ose më shumë fëmijë – Orët e punës në javë: Të paktën 16 orë në javë.

Nëse jeni çift me 1 ose më shumë fëmijë – Orët e punës në javë: Zakonisht, të paktën 24 orë* (njëri prej jush duhet të punojë të paktën 16 orë).

Për të aplikuar ose për të marrë informacion të mëtejshëm, kontaktoni:

Tax Credit Helpline

Telefoni: 0345 300 3900

Tekstfoni: 0345 300 3909

4A.15 Kufiri i ndihmave sociale

Kufiri i ndihmave sociale përcakton një kufi mbi pagesat e mirëqenies në mënyrë që shuma totale e ndihmave që merr çdo individ ose familje të jetë e kufizuar në një shumë maksimale prej:

- £500 në javë për prindërit e vetëm dhe çiftet me fëmijë
- £350 në javë për personat e vetëm.

Ndihma për strehimin do të reduktohet për të parandaluar që ndihmat totale të marra të mos kapërcejnë këto kufizime.

Kufiri aplikohet nëse nuk punoni dhe merrni ndihma si mbështetja mbi të ardhurat, ndihma për mbështetje dhe punësim dhe ndihma për të papunët. Ndihma për strehimin llogaritet në shumën maksimale të ndihmave që mund t'ju jepen, ndaj njerëzit që paguajnë qira të larta kanë më shumë të ngjarë që të ndikohen. Nuk mund të përfshihen në këtë kufi nëse ju ose një pjesëtar i familjes tuaj merrni disa lloje ndihmash. Kufiri nuk zbatohet në disa rrethana.

4A.16 Punësimi në Mbretërinë e Bashkuar

Pasi të keni marrë kartën tuaj biometrike jeni të lirë të punoni. Mbretëria e Bashkuar ka një pagesë minimale kombëtare. Ju lutemi kontrolloni që punëdhënësi juaj ta plotësojë këtë normë.

Shënim i rëndësishëm: Nëse keni mosmarrëveshje për pagesën ose ka praktika të paligjshme duhet të kontaktoni Zyrën tuaj vendore Citizens Advice Bureau.

Informacioni mbi zyrën më të afërt mund të gjendet në www.citizensadvice.co.uk

Kërkimi për punë

Nëse po kërkoni punë atëherë mund të shkoni në zyrën tuaj vendore të Job Centre për një listë të vendeve të punës. Do të ketë edhe një numër agjencish punësimi në zonën tuaj që afishojnë vende pune.

Shumë gazeta vendore ose kombëtare kanë njoftime për vende pune. Është e rëndësishme që të kontrollohet se punëdhënësi është me reputacion dhe po paguan të paktën pagën minimale.

Aplikimi për punësim

Punëdhënësit do të përcaktojnë se si duhet të aplikoni për një punë. Ka disa mënyra që mund t'ju kërkohet të aplikoni:

1) Një Curricul Vitae – Shpesh herë do ta dëgjoni ose do ta shikoni të përmendur si “CV”. Një punëdhënës mund t’ju kërkojë që t’u dërgoni një CV. CV-ja jep një pamje të përgjithshme të përvojës dhe kualifikimeve tuaja. Ju duhet të rendisni të dhënat tuaja personale, përvojën e shkollimit, historikun e punësimit dhe punën vullnetare. Zyra juaj vendore Job Centre mund t’ju ndihmojë me këtë gjë.

2) Një formular aplikimi për punë – Shumica e punëdhënësve do t’ju kërkojnë që të plotësoni një formular aplikimi për punë. Do t’ju duhet t’i telefononi ose t’i dërgoni email punëdhënësit dhe t’i jepni një adresë kontakti ku mund t’ju dërgojnë paketën e aplikimit për punë. Në këtë paketë do të ketë më shumë të dhëna rreth rolit. Specifikimet e punës do t’ju thonë aftësitë ose zotësitë që kërkohen. Është e rëndësishme që ju të keni aftësitë dhe përvojën e duhur për specifikimet e punës kur të aplikoni për vendin e punës.

3) Një intervistë – Pasi punëdhënësi ta ketë shqyrtuar aplikimin tuaj mund t’ju kërkojë që të ndiqni një intervistë për të vlerësuar më tej përshtatshmërinë tuaj për rolin. Intervista mund të bëhet me një individ ose me një panel njerëzish. Ata mund t’ju bëjnë pyetje që kanë lidhje me formularin tuaj të aplikimit, përvojën tuaj, aftësitë tuaja dhe përse e doni punën. Është një ide e mirë që të mbledhni informacion mbi kompaninë për të cilën do të punoni përpara intervistës dhe të kuptoni plotësisht rolin që ju kërkohet të mbuloni. Mendoni rreth pyetjeve që mund t’ju bëjnë dhe si do t’i përgjigjeni atyre.

Gjetët një punë?

Punëdhënësi juaj i ardhshëm do t’ju kërkojë që të provoni se ju lejohet të punoni përpara se të filloni punën. Duhet të tregoni kartën tuaj biometrike për ta provuar këtë. Do t’u duhet të paraqisni edhe numrin tuaj së sigurimeve shoqërore, edhe pse nuk jeni të detyruar që ta keni këtë numër që të filloni punë. Duhet që nga paga t’ju zbriten automatikisht taksat dhe sigurimet shoqërore. Nëse keni më shumë se një punë duhet të njoftoni punëdhënësit tuaj dhe zyrën e taksave në mënyrë që ata të mund të ndryshojnë kodin e taksave tuaja për t’u siguruar që të mos paguani më pak taksë se ç’duhet.

I vetëpunësuar / biznes i vogël

Mund të doni të jeni të vetëpunësuar ose të hapni një biznes të vogël. Shumë njerëz e bëjnë këtë gjë në mënyrë të suksesshme. Mund të kualifikoheni të aplikoni për hua dhe grante që të mbështeteni ta bëni këtë. Mund të kërkoni këshilla nga Citizens Advice Bureau për të parë se çfarë mbështetjeje ka që të ndihmoheni që ta bëni këtë. Duhet që po ashtu të flisni me zyrën e taksave në lidhje me taksat dhe sigurimet shoqërore.

Transferimi i kualifikimeve

Nëse keni kualifikime që mund të njihen në Mbretërinë e Bashkuar, organizatat e mëposhtme mund t’ju ndihmojnë:

NARIC Free Advice:

Nëse jeni refugjat mund të merrni këshilla falas rreth kualifikimeve tuaja në këtë numër telefoni: 0870 990 4088

4A.17 E drejta për shtetësi britanike

Ka shtatë kërkesa të cilat duhet t'i përmbushni përpara se të aplikoni:

- Duhet të jeni 18 vjeç ose më të mëdhenj.
- Duhet të jeni në gjendje të shëndoshë mendore (të kuptoni plotësisht veprimet tuaja).
- Duhet që të synoni të vazhdoni të jetoni në Mbretërinë e Bashkuar ose të vazhdoni të punoni për shërbimin e Mbretërisë, një organizatë ndërkombëtare ku Mbretëria e Bashkuar është anëtare ose shërbimin e një kompanie ose shoqate të krijuar në Mbretërinë e Bashkuar.
- Duhet të komunikoni në anglisht, uellsh ose gaelishte të Skocisë në një nivel të pranueshëm.
- Duhet të keni njohuri të mjaftueshme të jetës në Mbretërinë e Bashkuar.
- Duhet të keni karakter të mirë.
- Duhet të plotësoni kërkesat e banimit (shiko më poshtë).

Kufizimet kohore të imigracionit për shtetësinë britanike

Nuk duhet të keni kufizime kohore të imigracionit kur aplikoni për natyralizim (procedura ku një të huaji i jepet shtetësia). Nuk duhet të keni pasur kufizime kohore të imigracionit gjatë 12 muajve të fundit të periudhës kualifikuese të banimit. Kjo do të thotë se mund të aplikoni 12 muaj pasi t'ju jetë dhënë leje qëndrimi e përhershme.

Duhet që të keni qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar në mënyrë të ligjshme gjatë të gjithë periudhës kualifikuese të banimit. Kërkesa juaj për natyralizim mund t'ju refuzohet nëse keni shkelur ligjet e imigracionit gjatë kësaj periudhe. Mund të ushtrohet një lloj lirie veprimi mbi këtë kërkesë të banimit në vartësi të faktorëve që e kanë shkaktuar shkeljen.

Koha jashtë Mbretërisë së Bashkuar

Nuk duhet të keni qëndruar më shumë se 45 ditë jashtë Mbretërisë së Bashkuar në një periudhë 5 vjeçare përpara se të bëni aplikimin.

Nuk duhet të keni qëndruar më shumë se 90 ditë jashtë Mbretërisë së Bashkuar në periudhën 12 mujore përpara se të bëni aplikimin.

Nëse nuk i plotësoni këtë kërkesa por mendoni se ka rrethana të veçanta në rastin tuaj, duhet t'i shpjegoni ato kur aplikoni.

Karakteret e mirë

Që të jeni me karakter të mirë duhet të tregoni se keni ndjekur ligjin dhe detyrimet e Mbretërisë së Bashkuar.

Nuk do të konsideroheni me karakter të mirë nëse keni dënime penale. Këto përfshijnë dënimet me burg, gjokat ose shërbimin në komunitet. Nuk ka të ngjarë që t'ju jepet shtetësia derisa këto të jenë shlyer. Kjo është koha mbasi e keni kryer dënimin tuaj, përpara se ato të hiqen nga dosja juaj. Kjo varion nga 3 vjet deri në 15 vjet. Nuk ka të ngjarë që Home Office t'i japë shtetësinë një personi që është dënuar për 4 ose më shumë vjet.

Shtetësia britanike e fëmijëve

Nëse ju është dhënë së fundi 'Leja e përhershme e qëndrimit' (ILR) dhe keni një fëmijë që ka lindur në Mbretërinë e Bashkuar përpara kësaj, ju mund ta regjistroni fëmijën tuaj si shtetas britanik.

Nëse e lindni fëmijën pasi t'ju jetë dhënë 'Leja e përhershme e qëndrimit' atëherë fëmija juaj ka të drejtën të jetë britanik. Për më shumë informacion shihni: <https://www.gov.uk/becoming-a-british-citizen/check-if-you-can-apply>. Ju lutem vini re se ka tarifa janë të ndryshme për aplikimet e shtetësisë.

4A.18 Bashkimi familjar

Nëse ju është dhënë mbrojtje humanitare ose status refugjati do të keni të drejtën të aplikoni për bashkim familjar. Bashkimi familjar është që një pjesëtar para-ekzistues i familjes të bashkohet me familjen në Mbretërinë e Bashkuar. Ata do të mund të bashkohen nën të njëjtat kushte të lejes tuaj.

Kjo mund të përfshijë: bashkëshortët, partnerët civilë dhe partnerët e pamartuar ose të njëjtit seks. Kjo do të përfshijë edhe fëmijët nën moshën 18 që janë në vartësinë tuaj ose ishin pjesë e familjes tuaj kur jeni larguar. Kjo përfshin edhe fëmijët që nuk kishin lindur përpara nisjes tuaj.

Home Office mund të lejojë bashkimin familjar për pjesëtarë të tjerë të familjes nëse ka arsye dhembshurie përse çështja e tyre duhet të shqyrtohet jashtë rregullave të imigracionit. Më shumë informacion në lidhje me këtë mund të gjenden në faqen e internetit të Home Office në: <https://www.gov.uk/settlement-refugee-or-humanitarian-protection/family-reunion>

4A.19 Mësimet e anglishtes

Mund të doni ta përmirësoni anglishten tuaj. Kjo është një mënyrë e shkëlqyer për të kuptuar jetën në Mbretërinë e Bashkuar dhe për t'u integruar në komunitetin vendor. Mund të doni të mësoni anglisht për t'ju ndihmuar të gjeni punë, për t'ju mundësuar të studioni, për ndihmë me jetën e përditshme dhe ndihmë për shoqëri. Mund të ndiqni kurse ESOL (Anglishtja për Folësit e Gjuhëve të Tjera). Mund të filloni në nivelin që ju përshtatet ju. Ju do të vlerësoheni për të parë se çfarë niveli anglishteje keni dhe për t'u vendosur në një nivel të përshtatshëm.

Ju do të mësoni:

- Anglishten e folur
- Do të dëgjoni anglisht
- Leximin dhe shkrimin e anglishtes
- Fjalorin
- Pikëzimin dhe gramatikën

Që të aplikoni për një kurs ESOL duhet të kontaktoni kolegjin tuaj vendor për edukimin e mëtejshëm.

Kurset në përgjithësi fillojnë në shtator. Nëse keni probleme që të gjeni një kolegji që ofron një kurs të përshtatshëm ESOL, duhet të pyesni zyrrën tuaj vendore të punës për ndihmë.

Do të më duhet të paguaj?

Angli

Nëse merrni ndihmën për të papunët ose merrni ESA bazuar në punësim atëherë mësimet e anglishtes mund t'i merrni falas.

Uells

Në Uells kurset ESOL janë falas.

Skoci

Mund të aplikoni për fonde për mësimet e anglishtes nëpërmjet:

- Mbështetjes me pagesat dhe studentëve në Arsimin e Lartë
- Heqjes së pagesës dhe mbështetjes së veçantë me bursa për Edukimin e Mëtejshëm

Këtë mund ta bëni nëse jeni banor i zakonshëm në ditën e parë kur fillon kursi. Bashkëshortët, partnerët civilë ose fëmijët që plotësojnë kriteret e banorit të zakonshëm në Skoci po ashtu kualifikohen. Mund të kualifikoheni të aplikoni edhe për një Llogari Individuale Mësimi ose një Ndhmë Mirëmbajtjeje Shkollimi.